



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:089921

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06640185

PAKR.nr.437/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi - kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Skender Çoçaj - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorës profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.F nga fshati Ll..., Komuna Podujevë, për shkak të veprës penale, Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, (*Kodit Penal NR.04/L-082*), e ricilësuar vepër penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nenpar.3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), dhe të akuzuarit Fidan Maliqi nga Podujeva, Rr. Skënderbeu nr. 39, për shkak të veprës penale, Vrasje në tentativë në ndihmë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPK dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së (*Kodit Penal NR.04/L-082*), ricilësuar në vepër penale, Ndihmë në kryerjen e veprës penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nenpar.3.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-se (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), dhe Ndihmë në kryerjen e veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nen par.1.4 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), duke vendosur në lidhje me ankesën e përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi, si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, Sh.F, av. Nazim Mehmeti, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.353/2018, datë 12.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 19.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të

Rënda, PKR.nr.353/2018, datë 12.12.2023, sa i përket vendimit mbi dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin Sh.F, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, të cilin dënim do t'a mbajë pas pranimit të këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET e pa bazuar ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi.

III. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.353/2018, datë 12.12.2023, të akuzuarin Sh.F e ka shpallur fajtor për veprën penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) vite, dënim të cilin i akuzuari Sh.F do të fillojë t'a mbajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari është obliguar që të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej dyqind (200) euro, në emër të ekspertizës mjekoligjore shumën prej njëqind (100) euro, në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, ashtu që në tërësi shumën prej treqind e pesëdhjetë (350) euro, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

I dëmtuari P.K nga Podujeva, Rr."Llapi", për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

I akuzuari Fidan Maliqi bazuar në nenin 363 par. 1, nënpar. 1.3 të KPPRK-së, është liruar nga akuza për veprën penale, Ndhimë në kryerjen e veprës penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar.3.2, lidhur me nenin 33 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), dhe Ndhimë në kryerjen e veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), për arsye se nuk është provuar se tani i akuzuari Fidan Maliqi, ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Të dëmtuarit Shaip Babatinca nga Podujeva, Rr."Llapi", Albert Babatinca nga Podujeva, Rr."Llapi", dhe P.K nga Podujeva, Rr."Llapi", për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin, PKR.nr.353/2018, datë 05.02.2024, ka përmirësuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.353/2018, datë 12.12.2023, duke konstatuar se në dispozitiv, nën pikën I. të aktgjykimit gabimisht është përshtuar “....*më dashje që ta privojë nga jeta...*”, ndërsa duhet të jetë “....*me dashje që ta lëndojë...*”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Përfaqësuesi i të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi, për shkak të sanksionit penal, me propozim që Gjykata Apelit, aktgjykimin e ankimuar t’a ndryshoj ashtu që të akuzuarit Sh.F ti shqiptoj dënim më të rëndë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar t’a anuloj dhe çështjen t’a kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit më parashtrësën, PPA/I.nr.167/2024, datë 18.03.2024, ka propozuar që ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi, të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.353/2018, datë 12.12.2023, të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit Sh.F t’i shqiptohet dënim më i lartë me burgim, ndërsa ankesa mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PAKR.nr.172/2024, të datës 12.04.2024, ka aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.353/2018, datë 12.12.2023, sa i përket vendimit mbi dënim, ashtu që të akuzuarit Sh.F, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, dhe ka refuzuar të pa bazuar ankesën e përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin, Pml.nr.396/2024, të datës 16.07.2024, ka aprovuar si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit Sh.F, me pretendim se ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, por gjykata e shkallës së dytë nuk i ka dhënë të drejtën dhe mundësinë që të deklarohet lidhur me pretendimet ankimore, kurse aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.172/2024, të datës 12.04.2024, e ka anuluar dhe çështjen i'a ka kthyer gjykatës së njëjtë në rigjykim, duke konstatuar se është shkelur dispozita e nenit 384 par. 2, nënpar. 2.2 të KPPK-së, dhe e cila shkelje ka ndikur në të drejtat e të akuzuarit të garantuara sipas dispozitave të KPPK-së, dhe të drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 par.1 dhe 3 pika (c) dhe (d) i KELDNJ, pasi që gjykata e shkallës së dytë është dashur ta njoftoj për seancën e kolegjit të akuzuarin, duke obliguar gjykatën e shkallës së dytë që në rigjykim të eliminoj shkeljen e lartpërmendur, e pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, caktoi seancën e kolegjit më datë 29.10.2024, ku prezantoi i dëmtuari P.K, ndërsa nuk prezantuan: A. B, Sh.B, av. Fitim Gashi, av. Nazim Mehmeti dhe as Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse të njoftuar me rregull për kohën dhe vendin e mbajtjes se seancës. Po ashtu, nuk prezantoi as i akuzuari Sh.F dhe gjykata për këtë nuk ka provë se është njoftuar me rregull, andaj për këtë arsye seanca e kësaj dite është shty për datën 04.12.2024.

Në seancën e kolegjit të caktuar më datë 04.12.2024, prezantoi i dëmtuari P.K, ndërsa nuk prezantoi i akuzuari Sh.F e as mbrojtësi i tij, av. Fitim Gashi. Nuk prezantoi as Prokurori i Prokurorisë së Apelit Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës. Të akuzuarin Sh.F gjykata ka tentuar që ta njoftoj për seancën në adresën Sh.F, Rruga "17 Shkurti", fshati Dumnicë – Podujevë, mirëpo fletëdërgesa për dorëzim personal është kthyer me konstatimin "Pala është shpërngulur, nga kjo adresë jeton në Fushë Kosovë". Gjykata ka tetuar që të akuzuarin ta njoftoj për seancën e datës 04.12.2024, edhe në në adresën e të akuzuarit në Lagjen Ulpiana 30/3-3, Prishtinë, mirëpo fletëdërgesa për dorëzim personal është kthyer me konstatimin "I pa njohur". Seanca e kësaj dite është shty për datën 29.12.2024.

Në seancën e kolegjit të caktuar më datë 19.12.2024, nuk prezantoi askush nga palet e ftuara edhe pse i dëmtuari dhe Prokurori i Apelit ishin të njoftuara në mënyrë të rregullt. Gjykata për këtë seancë ka tentuar ta njoftoj të akuzuarin Sh.F, në adresën në fshatin Llaushë - Komuna e Podujevës, fletëdërgesa për dorëzim personal është kthyer me konstatimin "Tentim dorëzimi u

provua me 12.12.2024, pala ka ndërruar vendbanimin, jeton në Fushë Kosovë, adresa e panjohur”, gjykata ka tentuar që të akuzuarin ta njoftoj për seancën e datës 19.12.2024, edhe në fshatin, Llaushë, Komuna Skenderaj, mirëpo fletëdërgesa për dorëzim personal është kthyer me konstatimin “Me këtë mbiemër në fshatin Llaushë – Adresa jo e saktë”.

Gjykata Apelit ka dërguar njoftimin për senace për të akuzuarin Sh.F në të gjitha adresat që ka poseduar duke përfshirë edhe adresën në të cilën i akuzuari ka pranuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e që është fshati Llaushë, Komuna e Podujevës, por nga fletkthesa siç edhe u thekesua me lartë rezulton se i akuzuari ka ndërruar vendbanim.

Kolegji rikujton dispozitën e nenit 172 par. 4 të KPPK-së, sipas të cilës “*gjatë kohëzgjatjes së procedurës i pandehuri duhet menjëherë ta njoftoj gjykatën për çdo ndryshim të adresës së tij ose për qëllimin e ndryshimit të vendqendrimit...*” Në rastin konkret rezulton se i akuzuari Sh.F ka ndërruar adresën e banimit dhe për një gjë të tillë nuk e ka njoftuar gjykatën, andaj gjendur në një situatë të tillë kolegji penal i Gjykatës së Apelit erdhi në përfundim që seanca e kolegjit të mbahet konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tij dhe palëve tjera mungesa e të cilave u konstatu më lartë dhe kjo çështje të trajtohet ashtu që palët pastaj të njoftohen për vendimmarrje.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e përfaqësuesit të dëmtuarit, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, është pjesërisht e bazuar, ndërsa ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi, është e pabazuar.*

*Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi*

Në ankesë përfaqësuesi i të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi pretendon se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarit Sh.F i ka shqiptuar dënim relativisht të ulët krahasuar më pasojat që ka shkaktuar tek i dëmtuari. Gjykata shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitat që kanë të bëjnë me matjën e dënimit, edhe në rastin kur ka aplikuar rrethanat lehtësuese, ngase në rastin konkret, tek i akuzuari ka qenë vështirë të gjendën rrethana lehtësuese, ngase edhe gjatë momentit të shqiptimit të dënimit ka qenë me sjellje të vrazhdë dhe ofenduese si ndaj gjykatës dhe prokurorit të rastit, si dhe ndaj të dëmtuarit. Se i akuzuari nuk ka shprehur pendimin për veprën penale të kryer, nuk ka ndje keqardhje. Më tutje ka shtuar se lëndimi trupor ka ndikuar rëndë në

shëndetin e të dëmtuarit P.K, i njëjti tani më nuk është siç ka qenë para shkaktimit të këtij lëndimi, ka probleme shëndetësore, si dhimbje të kokës në kohën kur ndërron temperatura, ka dridhje të duarve, frikë, ankth, është bërë pothuaj se i paaftë për punë, ky rast pothuajse ja ka shkatërruar jetën, ngase edhe sot Patrioti është në kontrolla të vazhdueshme dhe terapi nga psikologu. Andaj, ka propozuar që Gjykata Apelit, t'a ndryshoj këtë aktgjykim në raport me sanksionin penal për të akuzuarin Sh.F, ashtu që të njëjtit ti shqiptoj dënim me të lartë.

*Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti*

Në ankesë mbrojtësi thekson se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 385 par. 2, nënpar. 2.7, lidhur me nenin 369 të KPPK-së, sepse aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 369 të KPPK-së, ku dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim të plotë me arsyetimin, sepse në dispozitiv (faqe 2) thuhet se i akuzuari Sh.F më dashje që ta privoj nga jeta, e ka goditur tre herë me kondakt të revolës në kokë, të dëmtuarin P.K, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata vlerëson se pas adiministrimit të provave materiale dhe personale në shqyrtim gjyqësor, saktësisht dhe në mënyrë të plotë ka provuar se i akuzuari Sh.F ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar. 3.2 të KPRK-së. Në faqen 24 të aktgjykimit, pika 19, gjykata thekson se nga të gjitha faktet e provuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ka rezultuar se i akuzuari Sh.F ka dashur që ta privojë nga jeta të dëmtuarin P.K, që është në kundërshtim të plotë me dispozitivin e aktgjykimit ku gjykata thekson më dashje që ta privoj nga jeta, pra, gjykata në kundërshtim me dispozitën e nenit 369 të KPPK-së, ka përpiluar aktgjykimin e ankimuar. Po ashtu, aktgjykimi i ankimuar është në kundërshtim me dispozitën e nenit 369 par.6 të KPPK-së, sepse gjykata në rastin konkret nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si dhe nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar.3.2 i KPRK-së, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, konkretisht nga neni 384 par.2 nën par.2.5 të KPPK-së, sepse aktgjykimi është bazuar në prova të papranueshme, për arsye se vendimin e saj gjykata e ka bazuar në prova të papranueshme, konkretisht në deklaratën e dëshmitarit P.K, dëshmitarit A.B dhe dëshmitarit Sh. B.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësi në ankesë ka thekësuar se me aktgjykimin e ankimuar me rastin e shpalljes fajtor të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar

gabimisht gjendjen faktike e cila ka pasuar me vendim jo të drejtë, për faktin se duke u nisur nga rrethanat e ngjarjes, deklaratimet e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve okular, rezultoi se i akuzuari Sh. F, nuk ka pasur qëllim për t'ua privuar nga jeta të dëmtuarin P.K dhe as ti shkaktojë lëndim të rëndë trupor.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal mbrojtësi në ankesë ka theksuar se gjykata shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal nga neni 385 i KPPK-së, e cila shkelje konsiston në faktin e kualifikimit juridik të veprës penale e cila është në shpërputhje të plotë me veprimet e të akuzuarit Sh.F, kjo sepse emërtimi ligjor i veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, nuk është në përputhje me përshkrimin e veprimeve inkriminuese si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket vendimit mbi dënim mbrojtësi në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin i ka tejkaluar kompetencat ligjore, shkelje kjo e paraparë me nenin 385 par. 1, nënpar 1.5 të KPRK-së, sepse nuk ka marrë parasyshë dhe nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese për të akuzuarin Sh. F dhe me këtë rast i ka shqiptuar dënim tejet të ashpër. Se po ti kishte marrë gjykata parasyshë të gjitha rrethanat lehtësuese, në bazë të tyre do të shqiptonte dënim me kusht. Në rastin e marrjes së vendimit gjykata është dashur t'ua merr parasyshë qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryerësit, i cili nuk ka kryer më parë veprë penale, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, koha e cila ka kaluar prej kryerjes së veprës penale, pra pesë vite. Andaj, duke pasur parasyshë edhe faktin se të akuzuarin Sh.F, gjykata e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale, që nga ajo kohë e deri më tash, nuk ka asnjë provë të vetme se i njëjti ka përsëritur veprën penale, si dhe faktin se Sh.F punon edhe jeton në shtetin e Gjermanisë, i cili është edhe shtetas gjerman, dhe me vite të tëra ka punuar për të fituar statusin e shtetasit gjerman, dënimi i shqiptuar prej katër viteve burgim do të ndikojë që mos prezenca e tij mbi gjashtë muaj në shtetin e Gjermanisë, do të humbë mundësinë që të vazhdojë të jetojë aty dhe do të humbë shtetësinë gjermane. Po ashtu, Sh.F është baba i tre fëmijëve të mitur, është kujdestar i vetëm i tyre sepse bashkëshortja e tij është e pa aftë në aspektin e gjendjes fizike dhe përkujdesja e saj për fëmijët është e pa mundur. I akuzuari ka shfaqur keqardhje para gjykatës në fjalën përfundimtare për rastin që ka ndodhur, si dhe në ditën kritike është paraqitur në stacion të policisë dhe ka ofruar ndihmë të dëmtuarve për shëndetin e tyre. Dënimi i shqiptuar në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrethanat e tjera që janë cekur më lartë, është jo adekuat, andaj edhe kërkon nga Gjykata Apelit që të akuzuarit t'ia zëvendësojë dënimin me burgim me dënim me kusht, pasi që janë plotësuar kushtet për t'iu shqiptuar dënim me kusht dhe me këtë dënim do të arrihej edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

## *Vlerësimi i Gjykatës së Apelit*

### *Të gjeturat për pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë e as që ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 370 par. 6 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, në ankesë thekson se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 385 par.2, nënpar. 2.7, lidhur me nenin 369 të KPPK-së, sepse aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 369 të KPPK-së, ku dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim të plotë me arsyetimin, sepse në dispozitiv (faqe 2) thuhet se i akuzuari Sh.F *më dashje që ta privoj nga jeta*, e ka goditur tre herë me kondakt të revolës në kokë, të dëmtuarin P.K, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit në faqen 24 të aktgjykimit, pika 19, gjykata thekson se gjatë shqyrtimit gjyqësor, *nuk ka rezultuar se i akuzuari Sh.F ka dashur që ta privojë nga jeta të dëmtuarin P.K*, që është në kundërshtim të plotë me dispozitivin e aktgjykimit ku gjykata thekson *më dashje që ta privoj nga jeta*, pra, gjykata në kundërshtim me dispozitën e nenit 369 të KPPK-së, ka përpiluar aktgjykimin e ankimuar.

Kolegji gjen të pabazuara keto pretendime ankimore nga se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin, PKR.nr.353/2018, datë 05.02.2024, ka përmirësuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.353/2018, datë 12.12.2023, ashtu që ka konstatuar se në dispozitiv, nën pikën I. të aktgjykimit të ankimuar gabimisht është përkthyer “....më dashje që ta privojë nga jeta...”, ndërsa duhet të jetë “....me dashje që ta lëndojë....”.



Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë. Vlerësimin e provave gjykata e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.1 të KPPK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga i akuzuari, për të cilën veprë penale i akuzuari Sh.F është shpallur fajtor. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejt objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë. Prandaj thënie ankimore se kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konstatohen të paqëndrueshme.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.5 të KPPK-së, sepse është bazuar në prova të papranueshme, konkretisht në deklaratën e dëshmitarit P.K, dëshmitarit Albert Babatinca dhe dëshmitarit Shaip Babatinca.

Kolegji e konsideron si të paqëndrueshëm pretendimin e tillë ankimor, ngase mbrojtësi në ankesë nuk jep asnjë arsye të vetme se pse dëshmitë e dëshmitareve të lartëcekur janë prova të papranueshme. Në aktgjykim janë paraqitë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara, si dhe janë vlerësuar provat në mënyrë të plotë. Nuk kemi të bëjmë me shkelje të nenit 384 par.2 nënpar.2.5 të KPPK-së, dhe se vendimi nuk bazohet në prova të pa pranueshme.

#### *Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Kolegji Penal i Gjykatës se Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale për pjesën vërtetuese dhe liruese e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për faktin se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Sh.F është kryes i veprës penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), ndërsa për të akuzuarin Fidan Maliqi nuk është vërtetuar se ka kryer veprat penale, Ndihmë në kryerjen e veprës penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar.3.2, lidhur me nenin 33 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), dhe Ndihmë në kryerjen e veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*).

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Sh.F në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ka kryer veprën penale duke vepruar me

dashje që t'a lëndojë e ka goditur tre herë me kondak të revolës në kokë të dëmtuarin P.K, ku nga kjo goditje i dëmtuari është alivanosur dhe ka pësuar lëndime të rënda trupore. Deri të vërtetimi i gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave dhe atë dëgjimin e dëshmitareve: P.K, A.B dhe Sh.B, M.K, A.R dhe V.D, dhe administrimit të provaveve material si në vijim: Raportin e vendit të ngjarjes i dt.20.02.2018, një CD, dy procesverbale mbi identifikimin e personit përmes fotografive të dt.20.02.2018, ekspertiza mjeko ligjore e dt.12.04.2018, për të dëmtuarit Albert Babatinca, ekspertiza mjeko ligjore e dt.23.03.2018, për lëndimet e të dëmtuarit Sh. B, ekspertiza mjeko ligjore për të dëmtuarin P.K, të dhënat e veturës "Golf 4", ekspertimi mjeko ligjore, i datës 30.11.2018, akt ekspertimi mjeko ligjore, i datës 03.10.2022, plotësimi i akt ekspertimit mjeko ligjore, i datës 11.05.2023 dhe foto albumet.

Të pabazuara kolegji gjen pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, se me aktgjykimin e ankimuar gjykata ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e cila ka pasuar me vendim jo të drejtë, për faktin se duke u nisur nga rrethanat e ngjarjes, deklaratimet e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve okular, rezulton se i akuzuari nuk ka pasur si qëllim të shkaktojë lëndim të rëndë trupor të dëmtuarit.

Kolegji gjen se gjykata shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke mos anashkaluar pretendimet e palëve, ka analizuar dhe vlerësuar me kujdes çdo provë të propozuar nga palët (prova të administruar në shqyrtim gjyqësor), në drejtim të provueshmërisë së fakteve relevante dhe fakteve të pretenduara nga palët. Nga provat personale dhe materiale, të lartë cituara, të siguruara dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor, në përputhje me dispozitat procedurale penale, ndryshe nga sa është pretenduar nga prokuroria "*..me dashje qe ta privoj nga jeta..*", është provuar plotësisht se i akuzuari Sh.F me veprime të kundërligjshme, me dashje, me kondak të armës, e ka goditur tri herë P.Kn dhe të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore. Në rrethana të tilla, në veprimet e të akuzuarit Sh.F, janë konsumuara elementët e figurës së veprës penale, Lëndim i rënde trupor nga neni 186 par.3, nenpar. 3.2 të KPRK-së. Andaj, kolegji penal i Gjykatës se Apelit duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

#### *Pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal dhe gjetjet e kësaj Gjykate*

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet e mbrojtjes se të akuzuarit se me aktgjykimin e ankimuar është shkelur ligji penal, e cila shkelje sipas mbrojtjes konsiston në faktin e kualifikimit juridik të

veprës penale e cila është në shpërputhje të plotë me veprimet e të akuzuarit Sh.F, kjo sepse emërtimi ligjor i veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, nuk është në përputhje me përshkrimin e veprimeve inkriminuese si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji vëren se gjykata shkallës së parë ka marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, të gjitha veprimet e të akuzuarit të ndërmarra në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe kualifikimin ligjor të veprës penale të pretenduar në aktakuzë, dhe ka arritur në përfundimin e drejtë se i akuzuari Sh.F ka kryer veprën penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3, nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*). Për këtë Gjykatë ky ri cilësim i veprës penale nga gjykata shkallës së parë nuk është kontestues, për faktin se Gjykata nuk është e lidhur me propozimin e prokurorit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, në këtë rast aktakuzën e prokurorisë, se i akuzuari ka kryer veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 20 të KPRK-së, (*Kodit Penal NR.04/L-082*), për faktin se gjykata shkallës së parë, duke vlerësuar të gjitha provat e paraqitura, më të drejtë ka arritur në përfundimin se veprimet e të akuzuarit, në kuptimin subjektiv dhe objektiv, kanë fituar të gjitha tiparet e veprës penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), për çka gjykata shkallës së parë ka ofruar arsyetim të detajuar, duke theksuar ndër të tjera se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari me dashje ka tentuar t'a privoj nga jeta të dëmtuarin P.K. Prandaj, në mungesë të elementit të dashjes për ta privuar nga jeta të dëmtuarin P.K si element qenësor të veprës penale për çka është akuzuar i akuzuari Sh.F, gjykata shkallës së parë më të drejtë ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*).

Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, ka paraqitur arsyet për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprën penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar. 3.2 të KPRK-së (*Kodi Penal Nr.06/L-74*), dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit sa i përket kësaj vepre penale. Provat në këtë çështje penale rezulton se janë vlerësuar në mënyrën e duhur, ashtu siç përcaktohet me nenin 360 paragrafi 2 të KPPK-së, arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar janë të qarta si për rrethanat objektive të veprës penale, vendin, kohën, veprimet, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe rrethanat e tjera të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, po ashtu edhe për tiparet subjektive - fajësinë e të akuzuarit. Është bërë analiza e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, lidhur me to janë paraqitur konkludimet, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë.

*Të gjeturat për vendimin mbi dënimin*

Duke vlerësuar çështjen lidhur me vendimin për dënim, kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi, për dënim më të ashpër, nuk janë të bazuara, ndërsa pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Sh.F, av. Nazim Mehmeti, për një dënim me të butë, janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat kanë ndikuar në caktimin, llojin dhe lartësinë e dënimit. Gjykata si rrethanë lehtësuese konform nenit 70 par.3 të KPRK-së, mori në konsideratë rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit. Nga të dhënat me të cilat disponon gjykata ka rezultuar se i akuzuari Sh.F është familjar dhe baba i tre fëmijëve të mitur dhe nuk ka precedentë të mëparshëm penal. Po ashtu, gjykata si rrethanë lehtësuese ka marr edhe faktin se pas kryerjes se veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari nuk ka ndërmarrë veprime inkriminuese në raport me të dëmtuarin por përkundrazi ka dërguar persona për pajtim. Si rrethanë rënduese konform nenit 70 par.1 dhe par.2 pika 2.1 të KPRK-së, gjykata ka marr në konsideratë shkallën e lartë të pjesëmarrjes se personit të dënuar, e cila rezulton nga veprimet aktive të ndërmarra nga ana e të akuzuarit. I vendosur për të kryer veprën penale ngase nga shkresat e lëndës rezulton se përderisa i dëmtuari P.K, së bashku me dy dëshmitaret Albert Babatinca dhe Shaip Babatinca kanë qene duke shkuar me veturë për të pirë kafe, në “Al Petrol”, janë ndaluar nga i akuzuari Sh.F, i cili së pari i’u ka bllokuar rrugën me veturën “Golf 4”, me ngjyrë të zezë, në afërsi të “Al Petrol”. Nga përpjekja e të akuzuarit Sh.F, për të ndaluar veturën e të dëmtuarit derisa ishte në lëvizje, rezulton një vendosmëri dhe këmbëngulje për t’u kryer veprën penale. Nga rrethanat e lartpërmendura rezulton se i akuzuari Shkelzen nuk ka qenë i provokuar nga i dëmtuari. Pas shkaktimit të lëndimit të dëmtuarit P.K është larguar nga vendi i ngjarjes me qëllim që të pamundësohet identifikimi i tij, si autor i veprës penale. Nuk ka shprehur pendim në asnjë fazë të procedurës penale dhe me asnjë veprim konkret, me të cilën mund të konkludohet se ka shprehur pendim apo keqardhje. Lëndimet në momentin e shkaktimit kanë qenë të rrezikshme për jetën e të dëmtuarit, ndërsa për pasojë ky lëndim ka shkaktuar pa aftësi fizik prej pesë përqind, andaj këto rrethana paraqesin një intensitet me të lartë të rrezikshmërisë apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Gjykata, vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të akuzuarit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrethanat e tjera që kemi cekur, është adekuat, dhe se gjykata është plotësisht e bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të akuzuarin Sh.F por edhe në raport me personat e tjerë, që të përmbahën nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit gjen se dënimi me burg për të akuzuarin i shqiptuar nga gjykata e shkallës parë në rrethanat e çështjes rezulton se është dënim i ashpër, duke mos pasur parasyshë rrethanat lehtësuese si: sjelljen e mëparshme të kryesit i cili nuk ka kryer më parë veprë penale, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, kohën e cila ka kaluar prej kryerjes së veprës penale, pra pesë vite, se që nga ajo kohë e deri më tash, nuk ka asnjë provë të vetme se i njëjti ka përsëritur veprën penale, rrethanat e tij personale dhe familjare, karakteri i tij si dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, faktin se është baba i tre fëmijëve të mitur për të cilët kujdeset, se ka shfaqur keqardhje para gjykatës në fjalën përfundimtare për rastin që ka ndodhur, si dhe në ditën kritike është paraqitur në stacion të policisë dhe u ka ofruar ndihmë të dëmtuarve për shëndetin e tyre, të cilat rrethana në tërësinë e tyre tregojnë se edhe me një dënim më të ulët, mund të arrihet qëllimi ndëshkues i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura kolegji penal i kësaj Gjykate për të akuzuarin Sh.F, ka ndryshuar vendimin mbi dënim dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, duke konsideruar se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Në rastin konkret për të akuzuarin gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes se dënimit dhe ndaj të akuzuarit ka bërë zbutjen e dënimit në kuadër të kufijve për zbutjen e dënimit, i ka shqiptuar dënimin me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nën minimumin e parapare ligjore, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 par.1, nënpar. 1 të KPK-së, lidhur me nenin 72 par. 1.3 të KPK-së.

Duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara, dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të akuzuarit Sh.F është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanave të kryerjes si dhe do t'i shërbej preventivës gjenerale dhe individuale, se me këtë dënim do të ndikoj që personat e tjerë të mos kryejnë vepra penale, kryesi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, do të bëhet rehabilitimi i tij, si dhe dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Kolegji trajtoj edhe pretendimet ankimore të përfaqësuesit të dëmtuarit P.K, av. Fitim Gashi, lidhur me rrethanat e pretenduara rënduese në ankesë se i akuzuari nuk ka shprehur pendimin për veprën penale të kryer, nuk ka ndje keqardhje, se lëndimi trupor ka ndikuar në shëndetin e të dëmtuarit, dhe gjeti se janë pretendime të cilave u ka dhënë përgjigje gjykata shkallës së parë, të cilat nuk e justifikojnë shqiptimin e një dënimi me të ashpër, andaj edhe u refuzua ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarit, si e pa bazuar.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 dhe 403 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.437/2024, datë 19.12.2024

B. Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Xhevdet Abazi

Skender Çoçaj